



Republika e Kosovës


Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit/Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës-Presednik Opštine-Municipal Mayor

Zyra për Informim



Raporti i punës së zyrës për Informim Janar- Qershor 2019

Gjatë kësaj periudhe, zyra për Informim në komunën e Rahovecit, është angazhuar në informimin sa më objektiv dhe në kohë reale për zhvillimet aktuale të Institucioneve komunale.

Në vazhdimësi, u janë dërguar ftesa, lajme dhe njoftime mediave lokale dhe atyre qendrore për përcjelljen, aktiviteteve të kryetarit të komunës.

-Gjatë kësaj periudhe Zyra për Informim, sëbashku me zyrën ligjore dhe zyrtarët tjerë ka përgatitur Planin Komunal të Veprimit për Transparencë 2019-2023, dhe është në përfundim të proceduarave edhe Rregullorja Komunale për Transparencë dhe Strategjia Avokuese për komunikim që është duke u përgatitur në bashkëpunim në mes të zyrtarëve komunal dhe zyrtarëve të OJQ “Syri i Vizionit”.

-Zyra për Informim, ka njoftuar opinionin e gjerë më zhvillimet aktuale përmes Web-faqes zyrtare <https://kk.rks-gov.net/rahovec/> në të cilën janë postuar lajmet ditore, ndërsa njoftimet, shpalljet e konkurset e ndryshme të institucioneve komunale të Rahovecit, janë bërë publike në bashkëpunim me zyrtarin e IT-së.

-Përgjatë kësaj periudhe raportuese kam vazhduar bashkëpunim me mediat, si ato lokale gjithashtu edhe me ato qendrore. Përmes adresave elektronike, gjitha mediave të shkruara, elektronike dhe agjencive të lajmeve u janë dërguar lajmet dhe fotot për ngjarjet e zhvilluara në komunën e Rahovecit.

-Po ashtu zyra për Informim është kujdesur për shkrimet e botuara në gazeta dhe agjensit e lajmeve të cilat kanë pasur të bënin me komunën e Rahovecit.

-Zyra për Informim, ka përcjell gjashtë mbledhjet të Kuvendit Komunal, njoftimet dhe lajmet u janë përcjellë me kohë gazetarëve.

-Zyra për Informim ka përcjell gjashtë mbledhjet të Komitetit për Politik e Financa, njoftimet dhe lajmet u janë përcjellë me kohë gazetarëve.

-Zyra për informim ka përcjellë edhe katër mbledhje të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi dhe katër mbledhje të Komitetit për Komunitete, njoftimet dhe lajmet u janë përcjellë me kohë gazetarëve.

- Të gjitha mbledhjet e Kuvendit Komunal, janë transmetuar dhe do të transmetohen në kohë reale në programin që ka komuna e Rahovecit në Youtub, poashtu mbledhjet janë transmetuar direkt edhe nga Radio Aktiv, ndërsa aktivitetet tjera komunale janë përcjell dhe transmetuar gjithashtu në Radio Aktiv, pasi që komuna ka kontratë dhe Zyra për Informim i ka monitoruar gjatë transmetimit.

-Si zyrtar për Informim jam marrë me plotësimin e dokumenteve dhe dhënien e komenteve, në dokumentet e pranuar nga OJQ-të të ndryshme të cilat kohë pas kohe, kanë publikuar raporte lidhur me transparencën e llogaridhënie për komunën e Rahovecit. Në disa raste pas dhënies së komenteve, ka ndodhur që është rritur është rritur përqindja e vlerësimit lidhur me transparencën dhe llogaridhënien e komunës së Rahovecit për këtë periudhë raportuese.

-Me vendim të kryetarit jam caktuar Zyrtar për shqyrtimin fillestar të kërkesave për Qasje në Dokumente Publike dhe për këtë periudhë kam pranuar 13 mëkresa të tilla, të gjitha kërkesave u është kthyer përgjigje pozitivisht nga Drejtorët e Drejtorive dhe zyrtaret e Sektorëve në afat sipas ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

-Gjatë kësaj periudhe janë publikuar **167** lajme, **76** njoftime-ftesa, **170** Vendime të nënshkruara nga kryetari të gjitha këto vendime në fund të çdo muaji janë dërguar tek zyrtari përkatës për pranimin e vendimeve në MAPL.

-Gjatë gjithë kohës në uebfaqe zyrtare të komunës, janë publikuar dokumente që kanë për qellim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies komunale siç janë: Raporti i Auditorit Kombëtar të Auditimi, raporti financiar për vitin 2018 dhe raporti 3 muajor financiar për vitin 2019. Janë publikuar edhe publikimet e OJQ-ve të ndryshme që kanë të bëjnë me transparencë dhe llogaridhënie, janë publikuar edhe Memorandumet e Bashkëpunimit të nënshkruara nga kryetari me Ministri apo edhe me OJQ të ndryshme, janë publikuar edhe kontratat e nënshkruara nga kryetari për mbështetje të OJQ-ve që veprojnë në komunën e Rahovecit. Janë publikuar raportet

e punës për drejtorët komunal dhe zyrtarët që i përgjigjen zyrës së kryetarit për vitin 2018 dhe raportet tre mujore të vitit 2019.

-Si rezultat i publikimit të dokumenteve, të cilat kërkohet të publikohet edhe me ligje, udhëzime dhe plane të ndryshme, komuna e Rahovecit si nga Ministritë gjithashtu edhe nga OJQ-të është vlerësuar shumë mirë.

-Gjatë gjithë kohës, në uebfaqe janë publikuar dokumente të cilat nuk kanë qenë të publikuara ndër vite, kjo është bërë në bashkëpunim me dy zyrtarët e IT-së, Dritan Sokoli dhe Petrit Haxhijaha.

Haziz Krasniqi, zyrtar për Informim



Rahovec, 01 Korrik 2019